



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

Tiranë, më 26.11.2018

NJOFTIM PËR MEDIAT

Bëjmë me dije që në funksion të një konkurrence të lirë dhe efektive në treg, misioni i Autoritetit të Konkurrencës është edhe ekzekutimi i masave administrative të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 59, datë 09.11.2007 “Për abuzim me pozitën dominuese në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme të Shoqërive Albanian Mobile Communication SHA. dhe Vodafone Albania SHA.”, vendosi të gjobisë ndërmarrjen **Vodafone Albania SHA me 242.633.000 lekë** dhe ndërmarrjen **Albanian Mobile Communication SHA me 211.552.000 lekë**.

Gjoba ndaj ndërmarrjes Albanian Mobile Communication SHA (sot Telekom Albania) është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 2076, datë 22.05.2018 **dhe vlera prej 211.552.000 lekë është ekzekutuar plotësisht** sipas urdhrit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv nr. 3359, datë 09.11.2010, duke kaluar në buxhetin e shtetit.

Gjoba ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2013-1829, datë 19.09.2013 **dhe vlera prej 242.633.000 lekë është ekzekutuar plotësisht** sipas urdhrit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv nr. 4281, datë 22.07.2011, duke kaluar në buxhetin e shtetit.

Asnjë nga gjobat e sipërcituara nuk ka ngelur pa u ekzekutuar nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, por janë ekzekutuar sipas procedurave ligjore përkatëse duke sjell arkëtimin e **454.185.000 lekë** në buxhetin e shtetit.